



BASHKIA KONISPOL

Raporti i Performancës 2022 për Qytetarin

DISCLAIMER

Dokumenti bazohet në të dhënat e konsoliduara të Raporti të monitorimit të zbatimit të buxhetit për vitin 2022, miratuar në Këshillin Bashkiak. Ky dokument është prodhuar nga Bashkia Konispol me asistencën e Projektit Bashki të Forta.

Përmbajtja

Fjalor Shpjegues	3
Vështrim i Përgjithshëm mbi Bashkinë	5
Të Dhënat e Përgjithshme të Bashkisë	6
Vështrim mbi Zbatimin e Buxhetit dhe Performancën e Shërbimeve.....	7
Burimet e Financimit	9
Shpenzimet Buxhetore.....	11
Treguesit Financiarë	13
Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi.....	14
Shërbimet e Policisë Vendore.....	15
Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	17
Mbështetje për Zhvillimin Ekonomik.....	19
Shërbimet Bujqësore, Inspektimi, Siguria Ushqimore & Mbrojtja e Konsumatoreve.	20
Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit	21
Administrimi i pyjeve dhe kullotave	23
Rrjeti rrugor rural	24
Transporti Publik.....	25
Shërbimet Publike Vendore.....	27
Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime.....	28
Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore	29
Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	30

Fjalor Shpjegues

Indikator / tregues performance

Një tregues i performancës është një matje që përdoret për të vlerësuar suksesin ose përparimin e një procesi, produkti ose aktiviteti specifik. Mund të përdoret për të gjurmuar arritjet kryesore të performancës, të tilla si performanca financiare, kënaqësia e klientit, produktiviteti i punonjësve ose efikasiteti operacional, ose buxhetor / financiar dhe për të përcaktuar nëse synimet ose objektivat po përmbushen. Treguesit e performancës përdoren shpesh në sektorin privat por edhe ate publik dhe organizata të tjera për të ndihmuar menaxherët të marrin vendime të informuara, të identifikojnë fushat e përmirësimit dhe të masin performancën e përgjithshme të bashkisë.

Produkt i bashkisë

Një produkt i realizuar nga bashkia i referohet një të mire materiale ose shërbimi që ofrohet nga bashkia, e cila është përgjegjëse për ofrimin e shërbimit apo të mirës materiale. Bashkitë sipas ligjit janë përgjegjëse për ofrimin e një game të gjerë shërbimesh publike, si transporti, kanalizimi, furnizimi me ujë, menaxhimi i mbetjeve, shërbimet e mbrojtjes nga zjarri dhe asaj civile etj.

Shembujt e produkteve bashkiake përfshijnë atë çfarë realisht prek qytetari. Produktet e bashkisë zakonisht financohen përmes taksave dhe burimeve të tjera të të ardhurave, të tilla si tarifatat e përdoruesve, grantet dhe transfertat e qeverisë dhe donatorëve si edhe huamarrja. Ofrimi i produkteve bashkiake është një aspekt i rëndësishëm i qeverisjes vendore, pasi ndihmon për të siguruar që banorët të kenë akses në shërbimet thelbësore që janë të nevojshme për shëndetin, sigurinë dhe cilësinë e jetës së tyre.

Indikator performance

Janë tregues të cilët llogariten me anë të formulave të cilët masin arritjen e një objekti specifiku në lidhje me shërbimin e bashkisë.

Taksat e ndara

Janë taksa kombëtare që mblidhen nga qeveria qendrore dhe ndahen plotësisht ose pjesërisht me bashkitë

Taksat vendore

Janë detyrime fiskale të bashkisë të cilat paguhet sipas parashikimeve ligjore dhe përcaktimeve të Këshillit Bashkiak

Tarifatat vendore

Janë detyrime që individët apo bizneset paguajnë kundrejt marrjes së një shërbimi të ofruar nga bashkia

Transfertat e kushtëzuara

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti i shtetit) i jep bashkisë për t'u përdorur vetëm për projekte të veçanta apo funksione të deleguara të bashkisë

Transfertat e pakushtëzuara

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti i shtetit) i jep bashkisë për t'u përdorur pa kushte, pa interes dhe pa të drejtë kthimi


Transferta e pakushtëzuar sektoriale

Janë fonde që Qeveria Qendrore (buxheti i shtetit) i jep bashkisë me kushtin për t'u përdorur vetëm për funksione specifike që bashkia i ka marrë nga Qeveria me ligj të veçantë

Trashëgimi nga viti i kaluar

Janë fonde buxhetore të bashkisë të cilat nuk janë shpenzuar në mbyllje të vitit buxhetor të kaluar dhe mund të përdoren në vitin korent buxhetor. Ato mund të jenë me destinacion dhe pa destinacion. Varësisht nga kjo ato mund të përdoren gjatë vitit korent me destinacion të përcaktuar (për ato projekte apo zëra buxhetor specifik për të cilat janë angazhuar gjatë vitit të kaluar por nuk kanë arritur të shpenzohen) apo pa destinacion (për cfarëdo zë apo projekt).

Vështrim i Përgjithshëm mbi Bashkinë



Bashkia Konispol është një nga 61 bashkitë e Republikës së Shqipërisë. Bashkia Konispol ndodhet në cepin më jugor të qarkut, rreth 30 km nga Bashkia e Sarandës. Ajo kufizohet në jug me kufirin shtetëror të Greqisë, në lindje me bashkinë Finiq dhe në perëndim me detin Jon. Një nga atraksionet turistike të kësaj bashkie është pika turistike e Buar-it, e vendosur në një kodër të mbuluar me pisha dhe shkurre. Prej këtij, shihet me sy të lirë horizonti i detit Jon, ishulli i Korfuzit, kodrat Stillo deri në Butrint. Lumi Pavlla kalon në gjithë fushën e Konispolit dhe derdhet në Detin Jon. Bashkia Konispol përbën një thesar të objekteve arkeologjike, kulturore dhe historike. Në këtë territor është trashëguar

një banesë shpellore, një nga më të rëndësishmit jo vetëm në Shqipëri, por edhe në Evropën Juglindore. Në këtë territor është zhvilluar sektori i blegtorisë, i favorizuar edhe nga tradita mijëvjeçare e banorëve. Sektori i bujqësisë është zhvilluar gjithashtu, sidomos në aspektin agrokulturor.

Disa nga sfidat kryesore të zhvillimit janë :

- Infrastruktura
- Menaxhimi i integruar i mbetjeve
- Zhvillimi i Biznesit Lokal
- Zhvillimi i bujqësisë
- Punësimi

Të Dhënat e Përgjithshme të Bashkisë

E DHËNA	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Synimi 2022
Popullsia totale nën administrimin e bashkisë		13705	13705	13705
Popullsia në qytet				
Popullsia në njësitë administrative				
Sipërfaqja totale e bashkisë (në km ²)	221.88	221.88	221.88	221.88
Sipërfaqe publike e bashkisë në km ²				
Sipërfaqja e njësive administrative në total				
Sipërfaqe totale e fondit pyjor (në ha)				
Sipërfaqe totale e fondit kullosor (në ha)				
Sipërfaqja e tokës bujqësore (në ha)		5010	5010	
Numri total i njësive administrative të bashkisë	3	3	3	3
Numri i fshatrave	15	15	15	15
Punonjës të bashkisë në total		125	122	135
Numri total i punonjësve femra të bashkisë		38	39	
Numri total i punonjësve meshkuj të bashkisë		87	83	
Numri total i punonjësve që punojnë për administratën e bashkisë		46	43	
Numri total i punonjësve femra që punojnë për administratën e bashkisë		16	16	

Vështrim mbi Zbatimin e Buxhetit dhe Performancën e Shërbimeve

Gjatë vitit 2022 buxheti i bashkisë është zbatuar në mënyrë të ekuilibruar dhe është realizuar në masën 85%, duke përdorur 96.2% të të ardhurave të përgjithshme të bashkisë. Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi, Rrjeti rrugor rural, Shërbimet Publike Vendore, etj janë shërbimet më të financuara nga bashkia gjatë vitit 2022.

Bashkia ka përmirësuar shërbimet e ofruara për komunitetin me anë të një fondi investimesh përmes të cilit janë financuar shërbime të tilla si: Rrjeti rrugor rural, zhvillimi bujqësor, etj. Bashkia ka ulur rritur ndjeshëm vlerën e investimeve për vitin 2022 me mbi 200% krahasuar me vitin 2021. Projektet e investimeve në vitin 2022 janë realizuar në masën 74% krahasuar me planin e këtij viti.

Performanca e ofrimit të shërbimeve ka ardhur duke u përmirësuar gjatë vitit 2022 në të gjitha shërbimet që ofron bashkia. Shërbimet në të cilat bashkia ka patur performancë më të mirë janë administrimi i bashkisë, transparencja dhe llogaridhënia, ujitja dhe kullimi, pyjet dhe kullotat, shërbimet publike vendore, etj.

Në vija të përgjithshme performanca e shërbimeve për vitin 2022 tregon se:


- Bashkia ka rritur transparencën dhe përfshirjen e komunitetit në vendimmarrje përmes shtimit të numrit të konsultimeve publike dhe realizimin e mbledhjeve të Këshillit të Bashkisë të hapura për qytetarët.
- Është ulur numri i punonjësve që kanë lëvizuar apo që janë larguar nga bashkia, duke bërë që të rritet qendrueshmëria e administratës së bashkisë.
- Bashkia ka patur performancë të mirë edhe përsa i takon menaxhimit financiar duke përdorur me efikasitet pothuajse të gjitha të ardhurat që janë mbledhur gjatë vitit.

- Bashkia është angazhuar në këshillimin dhe konsultimin e fermerëve që operojnë në territorin e bashkisë duke nxitur zhvillimin bujqësor.
- Bashkia ka rritur fondet për përmirësimin e infrastrukturës së kanaleve ujitëse dhe kulluese duke rritur njëkohësisht dhe cilësinë e shërbimit të ofruar. Bashkia është angazhuar në mirëmbajtjen, pastrimin dhe rikonstruksionin e kanaleve ujitëse dhe kulluese që janë nën administrimin e saj.
- Në vitin 2022 ka patur një rritje të konsiderueshme të fondeve për përmirësimin e shërbimeve publike si rehabilitimi i hapësirave publike, ndriçimi publik, mirëmbajtja e hapësirave të gjelbërta, shërbimi i varrezave etj.


Burimet e Financimit

Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Synimi 2022	Realizimi 2022
144,256	167,898	235,316	251,814	93%


Kategoria	Emërtimi	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Synimi 2022	Realizimi në %
TË ARDHURA NGA BURIMET E VETA	Të ardhurat nga taksat lokale	24,387	31,376	16,293	20,000	81%
	Të ardhurat nga tarifatat	19,567	18,868	27,509	40,300	68%
TË ARDHURA NGA BUXHETI QENDROR	Transferta e pakushtëzuar	49,525	61,475	62,899	62,899	100%
	Transferta e kushtëzuar	50,777	56,179	120,861	120,861	100%
TRASHËGIMI I NGA VITI I SHKUAR	Trashëgimi pa destinacion	0	0	7,754	7,754	100%
	Trashëgimi me destinacion	0	0	0	0	
TOTALI		144,256	167,898	235,316	251,814	93%



■ TË ARDHURA NGA BURIMET E VETA
■ TË ARDHURA NGA BUXHETI QENDROR
■ TRASHËGIMI NGA VITI I SHKUAR



■ TË ARDHURA NGA BURIMET E VETA
■ TË ARDHURA NGA BUXHETI QENDROR
■ TRASHËGIMI NGA VITI I SHKUAR



Dy fjalë mbi të ardhurat:

Të ardhurat e përgjithshme të bashkisë gjatë vitit 2022 janë rritur me rreth 40% krahasuar me vitin e kaluar 2021 dhe janë realizuar në masën 93% krahasuar me planin. Bashkia ka përfituar më shumë fonde nga transfertat e qeverisë gjatë vitit 2022.

Të ardhurat e veta të bashkisë kanë zënë mesatarisht 19% të të ardhurave të përgjithshme të bashkisë, ku peshën kryesore e kanë zënë të ardhurat nga tarifatat dhe taksat lokale.

Të ardhurat nga transfertat e qeverisë qendrore, ku përfshihen transfertat e pakushtëzuar, transfertat e pakushtëzuar sektoriale për funksionet e reja, që i janë transferuar Bashkisë dhe transfertat e kushtëzuar, zënë rreth 78% të të ardhurave të përgjithshme të bashkisë.


Shpenzimet Buxhetore

Fakt 2021	Fakt 2022	Plan 2022	Realizimi 2022
164,575	226,302	265,292	85%

Shpenzimet buxhetore sipas programeve

Shërbimi	Viti 2021	Viti 2022	Synimi 2022	Realizimi
Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi	49,449	54,007	63,559	85%
Rrjeti rrugor rural	16,691	48,592	56,327	86%
Shërbimet Publike Vendore	49,242	47,589	64,301	74%
Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	12,876	36,517	39,560	92%
Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	14,943	13,801	15,562	89%
Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime	8,992	11,324	11,339	100%
Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit	10,332	11,226	11,335	99%
Administrimi i pyjeve dhe kullotave	1,049	1,747	1,809	97%
Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore	1,000	1,500	1,500	100%

SHPENZIMET SIPAS KLASIFIKIMIT EKONOMIK NË VITE



Dy fjalë mbi shpenzimet:

Shpenzimet buxhetore për vitin 2022 kanë qenë 226,302 mijë lekë dhe janë realizuar në masën 85% krahasuar me shpenzimet e planifikuara për këtë vit. Shpenzimet e vitit 2022 janë rritur me rreth 38% krahasuar me një vit më parë, si pasojë edhe e rritjes së të ardhurave të përgjithshme të bashkisë.

Shërbimet më të financuara nga bashkia gjatë vitit 2022 janë:

Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi

Rrjeti rrugor rural

Shërbimet Publike Vendore

Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile

Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor

Treguesit Financiarë

Treguesi	Viti 2021	Viti 2022	Synimi 2022	Trendi
Norma e totalit të shpenzimeve ndaj totalit të të ardhurave	98.0%	96.2%	105.4%	▼
Norma e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore ndaj totalit të të ardhurave	29.9%	18.6%	23.9%	▼
Norma e të ardhurave nga burimet e veta ndaj totalit të të ardhurave	29.9%	18.6%	23.9%	▼
Norma e shpenzimeve kapitale ndaj totalit të shpenzimeve	14.8%	34.9%	40.0%	▲
Norma e shpenzimeve korrente ndaj shpenzimeve totale	85.2%	65.1%	60.0%	▼
Norma e shpenzimeve për paga dhe sigurime ndaj shpenzimeve totale	45.5%	33.6%	29.8%	▼
Norma e detyrimeve të prapambetura ndaj totalit të të ardhurave	0.0%	0.0%	0.0%	▬
Norma e shpenzimeve në politikatat sociale ndaj totalit të shpenzimeve	0.0%	0.0%	0.0%	▬

Dy fjalë mbi situatën financiare të bashkisë:

Gjatë vitit 2022, bashkia ka shpenzuar 96.2% të të ardhurave të mbledhura nga të gjitha burimet. Ky është një tregues i mirëmenaxhimit të financave lokale, trend i ruajtur ndër vite. Pesa e investimeve në buxhet është rritur ndjeshëm, duke përbërë rreth 35% të shpenzimeve buxhetore.

Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi

Shpenzimet e këtij program buxhetor përdoren për shërbimet



Administrimi dhe menaxhimi i bashkisë



Menaxhimi financiar



Gjendja civile

Shpenzimet e programit buxhetor

Kategoria	Viti 2021	Viti 2022	Synimi 2022	Realizimi
Paga dhe sigurime	32380	33661	36175	93%
Të tjera korrente	17068	17396	19434	90%
Kapitale	0	2950	7950	37%
Total	49449	54007	63559	85%

TREGUESIT E PERFORMANCËS

Shërbimi	Indikatori	Viti 2021	Viti 2022	Synimi 2022	Trendi
Administrimi dhe menaxhimi i bashkisë	Numri i punonjësve të bashkisë që kanë lëvizur brenda vitit kundrejt numrit total të punonjësve të bashkisë (raporti në %)	10	8		Zbritës
Menaxhimi financiar	Rritja e të ardhurave nga burimet e veta në % viti korent kundrejt vitit të kaluar	14	-13	20	Zbritës

TË DHËNAT E SHËRBIMEVE

E Dhëna	Njësia Matëse	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Synimi 2022
Shpenzime për investime programi administratës	lekë		0	2950000	7950000

E Dhëna	Njësia Matëse	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Synimi 2022
TOTALI I TË ARDHURAVE NGA BURIMET E VETA TE BASHKISE NE LEK	lekë	43954378	50243151	43802408	60300000
Shpenzime korente programi administratës	lekë		49448840	51056920	55609000
TOTALI I TË ARDHURAVE (TË VETAT QJ DONACIONE ETJ) (NË LEKË)	lekë	144256378	167897151	235316162	244059735
PUNONJËS TË BASHKISË NË TOTAL	numër		125	122	135
Numri i punonjësve që kanë lëvizur brenda vitit Meshkuj	numër	0	11	8	
Numri total i punonjësve në njësitë shpenzuese	numër		46	43	
NUMRI TOTAL I PUNONJËSVE QË PUNOJNË PËR ADMINISTRATËN E BASHKISË	numër		46	43	
NUMRI TOTAL I PUNONJËSVE TË BASHKISË QË KANË LËVIZUR NGA PUNA BRENDA VITIT	numër		13	10	
NUMRI TOTAL I PUNONJËSEVE FEMRA TË BASHKISË QË KANË LËVIZUR NGA PUNA BRENDA VITIT	numër		2	2	
NUMRI TOTAL I PUNONJËSVE FEMRA QË PUNOJNË PËR ADMINISTRATËN E BASHKISË	numër		16	16	
NUMRI TOTAL I PUNONJËSEVE FEMRA TË BASHKISË	numër		38	39	

Dy fjalë mbi realizimin e shërbimeve:

Menaxhimi dhe administrimi i bashkisë ka patur performancë të mirë. Është ulur numri i punonjësve që kanë lëvizuar apo që janë larguar nga bashkia, duke bërë që të rritet qendrueshmëria e administratës së bashkisë.

Bashkia ka patur performancë të mirë edhe përsa i takon menaxhimit financiar duke përdorur me efikasitet pothuajse të gjitha të ardhurat që janë mbledhur gjatë vitit.

Shërbimet e Policisë Vendore

Shpenzimet e këtij program buxhetor përdoren për shërbimet



Siguria në komunitet



Parandalimi i kundravajtjeve administrative

TREGUESIT E PERFORMANCËS

Shërbimi	Indikatori	Viti 2021	Viti 2022	Synimi 2022	Trendi
Parandalimi i kundravajtjeve administrative	Numri i akteve të ekzekutuara kundrejt akteve të nxjerra (në %)	0	0		Stabël
Shërbimet e Policisë Vendore	Shpenzimet buxhetore për shërbimet e policisë bashkiake kundrejt totalit të rasteve të menaxhuara (Lekë të shpenzuara për 1 rast të menaxhuar)	0	0		Stabël
Siguria në komunitet	Raporti midis punonjësve me status të oficerit të policisë bashkiake kundrejt numrit total të punonjësve të policisë bashkiake	25	25		Stabël
Siguria në komunitet	Raporti në % i numrit të punonjësve të trajnuar ndaj numrit të punonjësve total	0	0		Stabël
Siguria në komunitet	Raporti në % i ankesave dhe konflikteve të zgjidhura kundrejt numrit të tyre në total të ardhur në policinë bashkiake	75	87		Rritës
Siguria në komunitet	Ndryshimi vjetor i grupeve periodike te patrullimit ne numer		0		Stabël

TË DHËNAT E SHËRBIMEVE

E Dhëna	Njësia Matëse	Viti 2021	Viti 2022	Synimi 2022
NUMRI I PUNONJËSVE TË POLICISË BASHKIAKE TË TRAJNUAR	numër	0	0	0
NUMRI I AKTEVE ADMINISTRATIVE TË NXJERRA NGA ORGANET E QEVERISJES VENDORE	numër	2	2	
NUMRI I AKTEVE ADMINISTRATIVE TË EKZEKUTUARA NGA POLICIA BASHKIAKE	numër	0	0	

E Dhëna	Njësia Matëse	Viti 2021	Viti 2022	Synimi 2022
Raste konfliktesh/mosmarreveshjes te zgjidhura nga policia bashkiake	numër	15	20	
NUMRI I RASTEVE TË KONFLIKTEVE/MOSMARRËVESHJEVE TË RAPORTUARA DHE REGJISTRUARA NË POLICINË BASHKIAKE	numër	20	23	
Numri i grupeve te patrullimit te Policise vendore	numër	2	2	
NUMRI TOTAL I PUNONJËSVE TË POLICISË BASHKIAKE	numër	4	4	
PUNONJËS ME STATUSIN OFICER TË POLICISË BASHKIAKE	numër	1	1	

Dy fjalë mbi realizimin e shërbimeve:

Policia vendore ka punuar me efikasitet dhe eficientë duke zgjidhur një përqindje të lartë të ankesave dhe konflikteve të raportuara nga komuniteti. Bashkia nuk përdor program të dedikuar për shpenzimet e policisë, por shpenzimet janë të planifikuara në programin e administratës.

Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile

Shpenzimet e këtij program buxhetor përdoren për shërbimet



Shërbimi zjarrfikës



Emergjencat civile



Mbrojtja civile

Shpenzimet e programit buxhetor

Kategoria	Viti 2021	Viti 2022	Synimi 2022	Realizimi
Paga dhe sigurime	10494	10588	10603	100%

Të tjera korrente	1943	5591	8577	65%
Kapitale	439	20339	20380	100%
Total	12876	36517	39560	92%

TREGUESIT E PERFORMANCËS

Shërbimi	Indikatori	Viti 2021	Viti 2022	Synimi 2022	Trendi
Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	Numri i stacioneve MZSH	1	1	1	Stabël
Shërbimi zjarrfikës	Mbulimi kostove të shërbimit MZSH nga të ardhurat e shërbimit (në %)	0	0	0	Stabël

TË DHËNAT E SHËRBIMEVE






E Dhëna	Njësia Matëse	Viti 2021	Viti 2022	Synimi 2022
TOTAL SHPENZIME PËR MZSH (NË LEKË)	lekë	12876340	36517410	39560410
Numri i punonjesve te MZSH Meshkuj	numër	14	14	14
POPULLËSIA TOTALE NËN ADMINISTRIMIN E BASHKISË	numër	13705	13705	13705
NUMRI I STACIONEVE MZSH	numër	1	1	1
Familje të dëmshpërblyera për dëme nga zjarri	numër	0	0	0
FAMILJE TË DËMTUARA NGA FATKEQËSITË NATYRORE TË SHPËRBLYERA	numër	0	0	0
Numri i punonjesve te MZSH Femra	numër	0	0	0
TË ARDHURA NGA TARIFAT PËR SHËRBIMET SHITESË NGA ZJARRFIKËSJA (NË LEKË)	lekë	0	0	0

Dy fjalë mbi realizimin e shërbimeve:

Bashkia ka ofruar shërbime për mbrojtjen nga zjarri dhe mbrojtjen civile. Aktualisht bashkia ka 1 stacion MZSH si dhe 14 punonjës zjarrfikës, në përputhje me standardin e përcaktuar. Struktura është gjithnjë në gatishmëri për t'iu përgjigjur nevojave të komunitetit.

Mbështetje për Zhvillimin Ekonomik

Shpenzimet e këtij program buxhetor përdoren për shërbimet

	Tregjet publike
	Zhvillimi i turizmit
	Planifikimi strategjik
	Shërbime për mbështetjen e zhvillimit ekonomik vendor
	Mbështetja për zhvillimin e biznesit

TREGUESIT E PERFORMANCËS

Shërbimi	Indikatori	Viti 2021	Viti 2022	Synimi 2022	Trendi
Tregjet publike	Numri i rasteve të gjetura / inspektuara të tregimit të produkteve në tregje informale, ndryshimi vjetor në numër		0		Stabël

TË DHËNAT E SHËRBIMEVE

E Dhëna	Njësia Matëse	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Synimi 2022
TË ARDHURAT E BASHKISË NGA TAKSAT E NDARA (NË LEKË)	lekë		19118189	15068223	24021000
Totali i të ardhurave nga taksat vendore të bashkisë (ne leke)	lekë	24387499	31375554	16293050	20000000

E Dhëna	Njësia Matëse	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Synimi 2022
NUMRI I RASTEVE TË GJETURA/ INSPEKTUAR TË TREGTIMIT TË PRODUKTEVE BUJQËSORE DHE BLEGTORALE NË VENDE DHE TREGJE INFORMALE	numër		0	0	

Dy fjalë mbi realizimin e shërbimeve:

Në shërbimin e tregjeve bashkia nuk ka konstatuar asnjë rast të tregëtimit të produkteve në tregje informale.

Shërbimet Bujqësore, Inspektimi, Siguria Ushqimore & Mbrojtja e Konsumatoreve

Shpenzimet e këtij program buxhetor përdoren për shërbimet



Skemat vendore të granteve për bujqësinë



Administrimi dhe mbrojtja e tokave bujqësore



Mbrojtja e natyrës dhe biodiversitetit

TREGUESIT E PERFORMANCËS

Shërbimi	Indikatori	Viti 2021	Viti 2022	Synimi 2022	Trendi
Administrimi dhe mbrojtja e tokave bujqësore	Sipërfaqja e tokës bujqësore në vitin korent në ha minus sipërfaqen e tokës bujqësore në vitin e kaluar (në ha).		0		Stabël
Administrimi dhe mbrojtja e tokave bujqësore	Certifikata të pronësisë të aplikuara nëpërmjet bashkisë (Ndryshimi vjetor në numër)		0		Stabël

TË DHËNAT E SHËRBIMEVE

E Dhëna	Njësia Matëse	Viti 2021	Viti 2022	Synimi 2022
SHPENZIMET E PROGRAMIT NË LEKË	lekë	0	0	0
Dhenie toke me qera (ha)	ha	0	0	
NUMRI I CERTIFIKATAVE TË PRONËSISË TË REGJISTRUARA	numër	0	0	
SIPËRFAQJA E TOKËS BUJQËSORE (NË HA)	ha	5010	5010	
NUMRI I KAFSHËVE ENDACAKE TË TRAJTUARA	numër	0	0	
Konsultimi publik, keshillimi me fermeret e territorit të Bashkisë	numër	25	15	
Fermerë të mbështetur për zhvillimin rural dhe bujqësor	numër	0	0	
GRANTE TË DHËNA (NË LEKË) PËR MBËSHTETJEN E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL	lekë	0	0	
Numri i granteve vendore për skemat e bujqësisë në vit	numër	0	0	

Dy fjalë mbi realizimin e shërbimeve:

Bashkia ka 5010 tokë bujqësore e cila mund të shfrytëzohet dhe kultivohet nga fermerët. Në këtë drejtim bashkia është angazhuar në këshillimin dhe konsultimin e fermerëve që operojnë në territorin e bashkisë.

Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit

Shpenzimet e këtij program buxhetor përdoren për shërbimin



Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit

Shpenzimet e programit buxhetor

Kategoria	Viti 2021	Viti 2022	Synimi 2022	Realizimi
Paga dhe sigurime	2020	1960	1984	99%
Të tjera korrente	8312	9266	9351	99%
Kapitale	0	0	0	
Total	10332	11226	11335	99%

TREGUESIT E PERFORMANCËS

Indikatori	Viti 2021	Viti 2022	Synimi 2022	Trendi
Sipërfaqe bujqësore e mbuluar me ujitje (ndryshimi në ha kundrejt vitit të kaluar)		0		Stabël
Raporti në % i sipërfaqes bujqësore të kultivuar ndaj sipërfaqes totale bujqësore		28		
Shpenzime për pastrim dhe mirëmbajtje të rrjetit ujitës dhe kullues, kundrejt totalit të rrjetit të pastruar dhe mirëmbajtur (lekë/km)		196600		

TË DHËNAT E SHËRBIMEVE

E Dhëna	Njësia Matëse	Viti 2021	Viti 2022	Synimi 2022
SHPENZIME PËR PASTRIM DHE MIRËMBAJTJEN E SISTEMIT UJITËS DHE KULLUES NË LEKË	lekë	10331650	11225850	11335000
Shpenzimet për investime te programit ujitje kullimi	lekë	0	0	0
SIPËRFAQJA E TOKËS BUJQËSORE (NË HA)	ha	5010	5010	
NUMRI I STAFIT TË PROGRAMIT	numër	4	4	
SIPËRFAQE E TOKËS BUJQËSORE E MBULUAR ME SISTEM UJITËS (NË HA)	ha	2250	2250	

E Dhëna	Njësia Matëse	Viti 2021	Viti 2022	Synimi 2022
SIPËRFAQE E TOKËS BUJQËSORE E KULTIVUAR (NË HA)	ha		1420	
KANALE KULLUES TË RIKONSTRUKTUAR	km		34.9	
KANALE UJITËSE TË RIKONTRUKTUARA NË KM	km		22.2	
KANALE UJITËSE DHE KULLUES TË PASTRUAR/MIRËMBAJTUR (NË KM)	km		57.1	

Dy fjalë mbi realizimin e shërbimeve:

Shërbimi i ujitjes dhe kullimit ka qenë në fokus të bashkisë gjatë 2022. Bashkia ka rritur fondet për këtë shërbim duke rritur njëkohësisht dhe cilësinë e shërbimit të ofruar. Bashkia është angazhuar në mirëmbajtjen, pastrimin dhe rikonstruksionin e kanaleve ujitëse dhe kulluese që janë nën administrimin e saj.

Administrimi i pyjeve dhe kullotave

Shpenzimet e këtij program buxhetor përdoren për shërbimin



Administrimi i fondit pyjor dhe kullosor

Shpenzimet e programit buxhetor

Kategoria	Viti 2021	Viti 2022	Synimi 2022	Realizimi
Paga dhe sigurime	1049	678	679	100%
Të tjera korrente	0	1069	1130	95%
Kapitale	0	0	0	
Total	1049	1747	1809	97%

TË DHËNAT E SHËRBIMEVE

E Dhëna	Njësia Matëse	Viti 2021	Viti 2022	Synimi 2022
SHPENZIME PER MENAXHIMIN E FONDIT PYJOR NË LEKË	lekë	1048720	1747000	1809000
SHPENZIME PËR INVESTIME NË PYJE DHE KULLOTA	lekë	0	0	0

Dy fjalë mbi realizimin e shërbimeve:

Në përgjithësi bashkia ka patur një performancë të qëndrueshme në shërbimin e pyjeve dhe kullotave dhe ka kryer inspektime dhe monitorime të fondit pyjor dhe kullësor, me qëllim mbrojtjen e pyjeve.

Rrjeti rrugor rural

Shpenzimet e këtij program buxhetor përdoren për shërbimin



Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrugëve rurale

Shpenzimet e programit buxhetor

Kategoria	Viti 2021	Viti 2022	Synimi 2022	Realizimi
Paga dhe sigurime	1428	980	1010	97%
Të tjera korrente	5000	1395	1455	96%
Kapitale	10263	46216	53862	86%
Total	16691	48592	56327	86%

Projektet Kryesore të Investimeve

Emërtimi i Projektit	Vlera e Kontratës
RIKONSTRUKSION I RRUGES "QENDER KONISPOL - RRUGA NACIONALE", (LOTI I)	38606.784
RIKONSTRUKSION I RRJETIT TË NDRIÇIMIT RRUGOR, KONISPOL	9213.332

TË DHËNAT E SHËRBIMEVE

E Dhëna	Njësia Matëse	Viti 2021	Viti 2022	Synimi 2022
SHPENZIME PËR MENAXHIMIN E RRJETIT RRUGOR (NË LEKË)	lekë	16691080	48591940	56326650

Dy fjalë mbi realizimin e shërbimeve:

Bashkia ka realizuar disa investime në rrjetin rrugor rural duke përmirësuar infrastrukturën rrugore rurale në territorin e saj.

Transporti Publik

Shpenzimet e këtij program buxhetor përdoren për shërbimin



Transporti publik vendor

TREGUESIT E PERFORMANCËS

Indikatori	Viti 2021	Viti 2022	Synimi 2022	Trendi
Numri i linjave urbane të transportit publik (rritja vjetore në numër)		0	0	Stabël
Numri i linjave interurbane të transportit publik (rritja vjetore në numër)		0	-1	Stabël

Indikatori	Viti 2021	Viti 2022	Synimi 2022	Trendi
Numri i automjeteve të transportit publik urban (ndryshimi vjetor në numër)		0	0	Stabël
Numri i automjeteve të transportit publik interurban (ndryshimi vjetor në numër)		0	0	Stabël
Numri i njerëzve të mbështetur / subvencionuar, ndryshimi vjetor në numër		0	0	Stabël

TË DHËNAT E SHËRBIMEVE






E Dhëna	Njësia Matëse	Viti 2021	Viti 2022	Synimi 2022
NUMRI I LINJAVE INTERURBANE TË TRANSPORTIT PUBLIK	numër	10	10	9
NUMRI I AUTOMJETEVE TË TRANSPORTIT PUBLIK NDËRURBAN	numër	8	8	8
NUMRI I LINJAVE URBANE TË TRANSPORTIT PUBLIK	numër	4	4	4
NUMRI I AUTOMJETEVE TË TRANSPORTIT PUBLIK URBAN	numër	4	4	4
NUMRI I STAFIT TË PROGRAMIT	numër	2	2	2
NUMRI I LINJAVE TË TRANSPORTIT PUBLIK URBAN DHE NDËRURBAN	numër	16	16	16
NUMRI I AUTOMJETEVE TË TRANSPORTIT PUBLIK URBAN DHE NDËRURBAN	numër	12	12	12
NUMRI I BILETAVE PËR TRANSPORT TË SHITURA NË VIT	numër	0	0	0
NUMRI I NJERËZVE TË MBËSHTETUR/ SUBVENCIONUAR	numër	0	0	0
SHPENZIMET E BASHKISË PËR TRANSPORTIN PUBLIK (NË LEKË)	lekë	0	0	0

Dy fjalë mbi realizimin e shërbimeve:

Shërbimi i transportit publik ka vijuar të ofrohet me të njëjtën cilësi. Bashkia ka vënë në dispozicion të komunitetit një numër të konsiderueshëm linjash të transportit publik urban dhe ndërurban si dhe i ka pajisur me një numër të mjaftueshëm automjeteve duke siguruar që shërbimi të jetë cilësor dhe në përputhje me nevojat e komunitetit.

Shërbimet Publike Vendore

Shpenzimet e këtij program buxhetor përdoren për shërbimet

	<i>Shërbimi i dekorit publik</i>
	<i>Shërbimi i hapësirave të gjelbërta publike</i>
	<i>Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrugëve urbane</i>
	<i>Ndriçimi publik</i>
	<i>Shërbimi i varrezave publike</i>

Shpenzimet e programit buxhetor

Kategoria	Viti 2021	Viti 2022	Synimi 2022	Realizimi
Paga dhe sigurime	19444	19716	20245	97%
Të tjera korrente	25791	25373	28355	89%
Kapitale	4007	2500	15701	16%
Total	49242	47589	64301	74%

Projektet Kryesore të Investimeve

Emërtimi i Projektit	Vlera e Kontratës
ZGJERIM I VARREZAVE TE FSHATIT MURSI	4085.46

TË DHËNAT E SHËRBIMEVE

E Dhëna	Njësia Matëse	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Synimi 2022
Të ardhurat nga tarifat vendore	lekë	19566879	18867597	27509358	40300000
SIPËRFAQJA TOTALE E BASHKISË (NË KM2)	km2	221.88	221.88	221.88	221.88

Dy fjalë mbi realizimin e shërbimeve:

Shërbimet publike vendore kanë qenë në fokus të bashkisë. Në vitin 2022 ka patur një rritje të konsiderueshme të fondeve për përmirësimin e shërbimeve publike si rehabilitimi i hapësirave publike, ndriçimi publik, mirëmbajtja e hapësirave të gjelbërta, shërbimi i varrezave etj. Bashkia ka realizuar gjithashtu edhe një investim duke zgjeruar varrezat e fshatit Mursi.

Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime

Shpenzimet e këtij program buxhetor përdoren për shërbimet



Furnizimi me ujë



Shërbime sanitare dhe kanalizime

Shpenzimet e programit buxhetor

Kategoria	Viti 2021	Viti 2022	Synimi 2022	Realizimi
Paga dhe sigurime	0	0	0	

Të tjera korrente	2992	5709	5724	100%
Kapitale	6000	5615	5615	100%
Total	8992	11324	11339	100%

Projektet Kryesore të Investimeve

Emërtimi i Projektit	Vlera e Kontratës
MBROJTJE LUMORE NË LUMIN "PAVËLL" PRANË URËS SË "BOGAZIT"	16983.54

Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore

Shpenzimet e këtij program buxhetor përdoren për shërbimet



Mbrojtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore



Aktivite kulturore



Shërbimi i bibliotekave

Shpenzimet e programit buxhetor

Kategoria	Viti 2021	Viti 2022	Synimi 2022	Realizimi
Paga dhe sigurime	0	0	0	
Të tjera korrente	1000	1500	1500	100%
Kapitale	0	0	0	
Total	1000	1500	1500	100%

TË DHËNAT E SHËRBIMEVE

E Dhëna	Njësia Matëse	Viti 2021	Viti 2022	Synimi 2022
BUXHETI I ALOKUAR PËR KULTURËN (NË LEKË)	lekë	1000000	1500000	1500000
BILETA TË SHITURA PËR EVENTE KULTURORE	numër	0	0	0
NUMRI I SHFAQEVE KULTURORE; EVENTE ARTISTIKE TË MBËSHTETURA ME FONDET E BASHKISË	numër		1	
NUMRI I AKTIVITETEVE PROMOVUESE TË VLERAVE TË TRASHËGIMISË KULTURORE, TRADITËS, MUZEUT ETJ	numër		1	

Dy fjalë mbi realizimin e shërbimeve:

Në fushën e kulturës dhe trashëgimisë, bashkia ka mbështetur organizimin e aktiviteteve kulturore si shfaqe apo aktivitete të tjera me karakter promovues, duke nxitur zhvillimin social-kulturor në komunitet.

Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor

Shpenzimet e këtij program buxhetor përdoren për shërbimet



Arsimi parashkollor



Arsimi bazë

Shpenzimet e programit buxhetor

Kategoria	Viti 2021	Viti 2022	Synimi 2022	Realizimi
Paga dhe sigurime	7994	8364	8366	100%
Të tjera korrente	3324	4147	4616	90%
Kapitale	3626	1290	2580	50%
Total	14943	13801	15562	89%